



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2023-10/IA001

Vendosi: Kryetarja e Dhomave të Specializuara
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 28 dhjetor 2023

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Konfidencial

Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit

Gjykatësve të Panelit të Gjykatës së Apelit:

Gjykatëse Mishelë Pikar

Gjykatës Emilio Gati

Gjykatëse Nina Jorgensen

Zyrës së Prokurorit të Specializuar:

Kimberli P. Uest

Mbrojtjes së Sabit Januzit:

Xhonatan Elistan Ris

Mbrojtjes së Ismet Bahtijarit:

Hendrik Sitema

KRYETARJA e Dhomave të Specializuara ("Kryetarja"), duke vepruar në bazë të neneve 33(1)(c), 41(10) dhe 45(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, rregullave 58, 82(4), 169 dhe 170(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja") dhe rregullave 3 dhe 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë ("Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve"), cakton panelin e Gjykatës së Apelit për të marrë vendim lidhur me Apelin kundër Vendimit mbi Lirimin e Përkohshëm në emër të Sabit Januzit ("Apeli").¹

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 8 dhjetor 2023, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi Vendimin mbi Kërkesën e Sabit Januzit për Lirim të Përkohshëm" ku, ndër të tjera, rrëzoi kërkesën e z. Sabit Januzi për lirim të përkohshëm.²

2. Më 21 dhjetor 2023, z. Januzi dorëzoi Apelin.

II. KLASIFIKIMI

3. Apeli është klasifikuar si konfidencial dhe për rrjedhojë dhe ky vendim do të ketë të njëjtin klasifikim në pajtim me rregullën 82(4) të Rregullores, derisa të riklasifikohet më vonë në pajtim me rregullën 3(4) të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve.

III. CAKTIMI

4. Pas shqyrtimit të kriterëve të përcaktuara në rregullën 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve, duke përfshirë përvojën dhe kompetencën përkatëse, si edhe

¹ IA001/F00001, Apel kundër Vendimit mbi Lirimin e Përkohshëm në Emër të Sabit Januzit, 21 dhjetor 2023 (konfidencial).

² F00123, Vendim mbi Kërkesën e Sabit Januzit për Lirim të Përkohshëm, 8 dhjetor 2023 (konfidencial), para. 77.

disponueshmërinë në këtë moment,

KRYETARJA ÇAKTON:

Gjykatësen Mishelë Pikar

Gjykatësin Emilio Gati

Gjykatësen Nina Jorgensen

në panelin e Gjykatës së Apelit për të vendosur mbi Kërkesën.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova
Kryetare e Dhomave të Specializuara

E enjte, 28 dhjetor 2023
Në Hagë,
Holandë